



Appi Edlevo Lajmërimi i mungesave

Lajmërimi i mungesave për fëmijë dhe nxënës duhet të regjistrohet para fillimit të mësimin apo aktiviteteve, nga prindi përmes appit Edlevo. Ti mund ta lajmërosh fëmijën tuaj të sëmure vetëm për një ditë, sot ose nesër.

Kur nxënësi t'i ketë bërë 18 vjet ti si prind nuk mund ta lajmërosh më mungesën e fëmijës tuaj. Nxënësit e moshës madhore në gjimnaz i lajmërojnë vetë mungesat e tyre.

Nëse kërkohet leje për pushim nga shkolla udhëzohesh te www.kristianstad.se shërbimet elektronike. Parashkollori dhe institucioni i kohës së lirë regjistrohen përmes orarit mësimor të fëmijëve në appin Edlevo. Në javën aktuale shënjohe e lirë tërë java ose me rastin e disa ditëve të veçanta e lën ditën aktuale bosh (pa kohë). Më shumë informacion ka në www.kristianstad.se/registrerabarnschema

Lajmërimi i mungesave

Në appin Edlevo e zgjedh ti mungesën dhe e shënjon atë/ata fëmijë që do të lajmërohen të mungueshëm. Ti mund të zgjidhësh

- Tërë ditën si dhe sot ose nesër.
- Kohë të kufizuar që është pjesë e ditës ku ti e shënon datën dhe orën për mungesë.

Nëse fëmija yt është i vendosur në institucionin e kohës së lirë dhe lajmërimi i mungesës bëhet për një ditë të tërë do të jetë mungesa si për shkollën ashtu dhe për institucionin e kohës së lirë. Nëse bëhet fjalë vetëm për institucionin e kohës së lirë atëherë do të zgjedhet mungesa e kohës së caktuar si dhe regjistroj kohët aktuale të institucionit të kohës së lirë.

Mungesa e lajmëruar

Këtu mund ta shihesh cila mungesë është bërë për fëmijët tuaj. Nëse bëhet fjalë për sot ose për të ardhmen mund ta fshish mungesën e lajmëruar duke klikuar në koshin e plehërave.

Raportimi i mungesave

Këtu shihen mungesat dhe nëse është shkolla shfaqet mungesë e arsyeshme dhe mungesë e paarsyeshme.

Njohtimet për parashkollor dhe institucionin e kohës së lirë

Në appin Edlevo ka mundësi të dërgimit të njohtimeve në parashkollor dhe institucionin e kohës së lirë duke e shtypur shenjën e plusit dhe në rubrikën njohtime informative të shënjohe se për cilin fëmijë bëhet fjalë. Shtype tutje sustën poshtë në këndin e djathtë për ta shkruar njohtimin tuaj dhe dërgoje atë. Njohtimi shfaqet në përmbledhjen e mungesave për pedagogë në parashkollor dhe institucionin e kohës së lirë.